



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

Nr. 1038/2 Prot.

Tiranë, më 08.04.2025

VENDIM

Nr. 45, datë 07.04.2025

**“PËR
MIRATIMIN E TESTEVE PRAKTIKE DHE RREGULLORES SË KONKURSIT TË
PRANIMIT NË PROGRAMIN E CIKLIT TË PARË BACHELOR
NË “SHKENCA TË LËVIZJES” PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026”**

Mbështetur në nenin 3 pika 4 gërma “b”, 38, 69 pika 3, 73, 74 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”; nenin 7 pika 4 gërma “b”, 20, 72, 74, të Statutit të UST; në vijim të shkresës së Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes nr.618/1 Prot., datë 06.03.2025 dhe Vendimit të Rektoratit nr. 42, datë 28.03.2025, Senati në mbledhjen e datës 07.04.2025;

VENDOSI:

1. Miratimin e testeve praktike dhe rregullores së konkursit të pranimit në programin e ciklit të parë bachelor në “Shkenca të Lëvizjes” për vitin akademik 2025-2026.
2. Ky Vendim i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Agron KASA

